

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), ka hapur thirrjen për aplikime për Komponentin e Praktikës Profesionale në SH.B.A.

Programi synon rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të rinj, me minimumi 3-5 vjet eksperiencë pune, pjesë të sektorit publik dhe privat, të cilët punojnë në fusha si: Studime Arsimore, Menaxhim dhe Administrim Arsimor, Teknologji dhe Inovacion, Menaxhim projekti, Sipërmarrje, Biznes, Zhvillim, Turizëm Kulturor dhe Eko-Turizëm dhe që janë të përkushtuar të adresojnë sfidat e ardhshme në fushat e sipërpërmendura, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Së bashku me përvojën e punës, përfituesit ndjekin dhe një program trajnimi në fushat e interesit.

**Kohëzgjatja e internshipit është 6 muaj. Afati për aplikime është 15 Mars 2019, ora 17:00.**

Për më shumë informacion, ju lutem të vizitoni <https://www.mip-aadf.org/> dhe [https://www.mip-aadf.org/apply\\_inter.html](https://www.mip-aadf.org/apply_inter.html).